



Raporti Vjetor

**Këshilli Kombëtar për
Ekonomi dhe Investime**

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Rezultatet e arritura:.....	4
Situata ekonomike në Kosovë.....	6
Aktivitetet e Fundit	8
Dukshmëria dhe Transparenca.....	8
Takimet e Këshillit.....	9
Takimi i KKEI i kryesuar nga Kryeministri Hoti – 20 Gusht 2020.....	9
Takimet e KKEI me përfaqësuesit shtesë të sektorit.....	10
Takim i KKZHE – Mbledhje e jashtëzakonshme rreth pandemisë Covid-19 – Prill 14, 2020.....	10
Takimi i 9 i KKZHE-14 Janar 2019.....	11
Grupet punuese dhe Takimet Teknike	12
Takim i nivelit të lartë më Ministrin e Drejtësisë dhe Gjyqtarin e Gjykatës Komerciale – Maj 28, 2020	12
Takim i nivelit të lartë me Grupin Koordinues rreth çështjeve ekonomike të ndërlidhura me Covid-19 - 5 Maj, 2020	13
Takim Konsultativ i nivelit të lartë – Ministrat e MEPTINIS, MFT dhe MSH – Prill 28, 2020.....	14
Takim i Grupit i nivelit të lartë me Ministrin e Financave dhe Transfereve dhe Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës – 16 Prill, 2020	15
Takimi i Grupit Punues për Ligjin e Tregtisë së Brendshme me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.....	16
Takimet me sektorin privat.....	16
Tryezë e rumbullakët me Sektorin Privat – Nëntor 14, 2019.....	16
Tryezë e Rumbullakët me Sektorin Privat – prill 24, 2019.....	17
Raporte të tjera Analitike	18
Duke shikuar përpara	19

Hyrje

Sekretariati i KKEI ka filluar një strategji dhe program të ri me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky program ka filluar në bazë të një Memorandumi të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe BERZH (nënshkruar nga Kryeministri i Kosovës) i cili ka për qëllim përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes, investimeve si dhe qeverisjes së mirë në Kosovë.

Në këtë memorandum BERZH-i ka marrë përsipër mbështetjen dhe forcimin e ndikimit dhe efikasitetin e dialogut publiko-privat përmes mbështetjes së Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

Sekretariati i KKEI ka për qëllim të ofrojë mbështetje analitike në punën e Këshillit si dhe të monitorojë zbatimin e rekomandimeve dhe konkludimeve të Këshillit si dhe të ndërmarrë veprime kur ato nuk janë zbatuar në kohë.

Bazuar në përvojën e BERZH-it në krijimin dhe financimin e Sekretariatit të platformave të ngjashme të dialogut publiko-privat në të gjitha vendet e saj të funksionimit dhe njohjen e angazhimit të vërtetë të qeverisë për reformën e klimës së investimeve dhe bazat e saj të forta të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, BERZH u zotua të mbështesë një Sekretariat profesional të pavarur për të marrë këto funksione. BERZH do të monitorojë nga afër progresin në vend dhe do të bëjë ndryshime / përmirësime ku është e mundur, për të siguruar funksionimin efektiv të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

KKEI (Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime) është platformë gjithëpërfshirëse për dialogun e nivelit të lartë ndërmjet qeverisë dhe komunitetit të biznesit, ku anëtarë janë edhe përfaqësuesit ndërkombëtar (donatorët aktivë në zhvillim ekonomik). KKEI ka për qëllim të adresojë prioritetet dhe sfidat, të zbatojë të gjitha reformat gjithëpërfshirëse me qëllim të mbrojtjes së ambientit të të bërit biznes, eliminimit të barrierave, forcimit të sektorit privat në Kosovë dhe tërheqjen e investimeve të huaja në vend.



Anëtarët janë përfaqësues të Ministrive përkatëse si dhe Odave apo Asociacioneve kyçe të bizneseve në Kosovë. Kjo platformë është e dizajnuar për të krijuar qasje gjithëpërfshirëse në mënyrë që të sigurohet koordinim i plotë ndërmjet palëve.

Këshilli forcon rolin e sektorit privat dhe Asociacioneve të biznesit në monitorimin e efikasitetit të reformave të qeverisë.

Për të rritur efikasitetin e punës së Këshillit dhe për t'a bërë një platformë

konstruktive për dialogun publiko-privat, Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është pajtuar t'a mbështesë këtë Këshill, bazuar në një Memorandum të Mirëkuptimit të nënshkruar nga qeveria e Kosovës (nënshkruar nga z. Isa Mustafa, ish-Kryeministër i Kosovës), për përmirësimin e klimës së të bërit biznes, investimeve dhe qeverisjes së mirë në Kosovë. Mbështetja e BERZH ndaj Këshillit ka të bëjë me krijimin dhe financimin e një Këshilli të përbërë nga profesionistë të pamvarur.

NCEI 2019–2020

Sekretariati profesional i KKEI ka për qëllim të ofrojë mbështetje analitike për punën e Këshillit, mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve dhe konkludimeve të Këshillit, dhe të përcjellë kur rekomandimet nuk implementohen në kohë. BERZH do ta vlerësojë nga afër progresin e bërë në vend dhe do të bëjë ndryshime / përmirësime ku është nëvoja, në mënyrë që të sigurohet një funksionim efikas i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.



Rezultatet e arritura:

- ✓ **Ekipi i ekspertëve të paanshëm është kompletuar përmes një procesi transparent me qëllim ngritjen e Këshillit në një nivel profesional dhe analitik**
- ✓ **Rregullorja e KKEI është ri-hartuar bazuar në ndryshimet e Ligjit për Qeverinë dhe ndryshime të tjera të lidhura me të;**
- ✓ **Ri-aktivizimi i grupeve punuese mbi baza tematike.**
- ✓ **Janë mbajtur takime konstruktive të punës me përfaqësuesit e sektorit privat / anëtarë të KKEI**
- ✓ **Është draftuar dokumenti me kërkesat / prioritetet e sektorit privat për vitin e ardhshëm;**
- ✓ **Takimet po mbahen vazhdimisht me nëngrupet punuese në lidhje me aftësitë e punës në tregun e punës dhe pengesat administrative**
- ✓ **Kemi dizajnuar një faqe të re të internetit dhe kemi aktivizuar faqet e rrjeteve sociale me qëllim të rritjes së transparencës në vendime dhe punën e këshillit;**
- ✓ **Kemi forcuar bashkëpunimin me kabinetin e Kryeministrit;**
- ✓ **Prezantimi i rolit dhe ndikimit të Këshillit në qeverisjen e mirë të vendit tek anëtarët e rinjë.**
- ✓ **Rrjetëzim me palët e interesit të KKEI**
- ✓ **Analizimi i disa prej temave me prioritet në mënyrë që të lehtësohet vendim marrja.**
- ✓ **Kriteret për anëtarësim dhe anëtarët nga sektori privat janë shqyrtuar dhe përditësuar.**

Detajet e Këshillave të Investimeve të mbështetura nga BERZH:

Gjatë dekadës së kaluar, BERZH ka mbështetur krijimin dhe forcimin e platformave për dialog publiko-privat, ku bizneset dhe politikëbërësit bëhen bashkë në mënyrë që të adresojnë sfidat e klimës së investimeve në mënyrë sistematike dhe të orientuar drejt rezultateve.

Në disa vende, BERZH ka mbështetur themelimin e Këshillave të Investimeve duke zgjedhur zyrtarë të lartë, asociacone të bizneseve dhe agjencitë shumëpalëshe, duke themeluar Sekretariatit për Këshillin e Investimeve i cili do të ofrojë mbështetje analitike, organizative dhe profesionale për anëtarët e saj.

BERZH-i ka themeluar Këshillin e parë të Investimeve në vitin 2007 si pjesë e Iniciatives së Shteteve të Azisë Qëndrore. Këto Këshilla nuk kanë qëllim të zëvendësojnë aktivitetet e ndonjë Ministrie, Agjencie apo Institucioni. Përkundrazi, këto janë të dizajnuara për të ofruar një platformë dialogu në mes sektorit privat dhe autoriteteve në mënyrë që të përdoret përvoja e

sektorit privat për të përmirësuar përmbajtjen dhe dobinë nga reformat e politikave të qeverisë. Poashtu, Këshillat e Investimeve forcojnë rolin e sektorit privat si dhe shoqërisë civile në monitorimin e efikasitetit të aktiviteteve të qeverisë në reformat qeverisëse.

Kryeministri apo Presidenti është udhëheqësi i Këshillit. Këshillat e Investimeve nuk funksionojnë vetëm për të mbështetur sektorin



privat, ata janë pjesë e një grupi kompleks të institucioneve, politikave dhe reformave. Për dialogjet publiko-private, këto platforma luajn një rol jetik duke kontribuar në një situatë të qëndrueshme ekonomike.

Hapi i parë në identifikimin e një potenciali konkret për biznes është, sigurisht, hyrja në dialog. Në mënyrë që partneriteti të zhvillohet me të vërtetë, ndëgjimi, zgjedhjet e duhura të politikave, dhe planifikimi afatgjatë duhet të jetë në top prioritetet e qeverisë.

- Në njërën nga shtetet, Këshilli ka kontribuar në miratimin dhe amendamentimin e më shumë se 100 ligjeve dhe rregulloreve të rëndësishme që nga krijimi i tij në vitin 2007.
- Në njërën nga shtetet, platforma vendore për dialogun publiko-privat, ka mbështetur autoritetet në procesin e reformave në sistemin e inspektimit, i cili çoi tek përmirësimi i renditjes së performancës së të bërit biznes në renditjen e Bankës Botërore.
- Në njërën nga shtetet, Këshilli krijoi një forum në të cilin zyrtarët shtetëror dhe sektori privat u pajtuan në fillimin e reformave me qëllim të thjeshtësimit të procedurave për regjistrimin e bizneseve si dhe marrjen e lejeve dhe licencave.
- Në një shtet tjetër Këshilli Ekonomik ka qenë i suksesshëm në sigurimin e aprovimit të një numri të konsiderueshëm rregulloresh nga qeveria, duke përfshirë këtu edhe lehtësimin e kërkesave për eksport/import. Këshillat e Investimeve promovojnë qeverisjen korporative, këto përmirësojnë kualitetin e këshillave të dhënë ndaj qeverisë nga sektori privat. Megjithatë, kjo qëndron e vërtetë përderisa këto platforma qëndrojnë transparente, të pavarura dhe gjithëpërfshirëse.

Situata ekonomike në Kosovë


Kosova është një vend me të ardhura të mesme-të ulëta që ka përjetuar një rritje solide ekonomike gjatë dekadës së kaluar. Kosova është një nga katër vendet e vetme të Evropës të cilat përjetojnë rritje çdo vit që nga fillimi i krizës globale financiare të vitit 2008.

Modeli i rritjes mbështetet shumë në remitancat për të furnizuar konsumin e brendshëm, por së fundmi është zhvendosur në rritjen përmes investimeve dhe eksportit. Kosova aktualisht ka një rritje prej 4% mesatarisht përgjatë dekadës së fundit dhe shkalla e papunësisë është në 27.5%. Ndër çështjet më të rëndësishme me të cilat përballen qytetarët e Kosovës janë: kujdesi shëndetësorë, edukimi, papunësia, dhe fakti që një pjesë e madhe e rinisë dëshirojnë të largohen nga vendi. Sa i përket kritereve ekonomike, Kosova është në një fazë të hershme dhe ka bërë disa përparime në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Rritja ekonomike ishte e fortë, por situata mjaft sfiduese e tregut të punës mbetet një shqetësim.

Bazuar në të dhënat tremujorëshe të vitit 2019, vlerësimi i përkohëshëm i rritjes vjetore të PBB është 4.2%, kryesisht të udhëhequra nga investimet private në sektorin e ndërtimitarisë. Në tremujorëshin e tretë, ka pasur disa përmirësime në tregun e punës, mirëpo filloi të devijonte gjatë fundit të vitit. Nga ana e investimeve, hyrjet totale neto te IHD qëndruan në 3.8% të PBB në vitin 2019, duke mbuluar më shumë se gjysmën e deficitit të llogarisë së tanishme. Para shpërthimit të pandemisë Covid-19, sektori financiar konsiderohej të jetë likuide dhe të jetë e mirë kapitalizuar. Treguesit e shëndetit financiar në sektorin e bankave kanë qëndruar kënaqshëm gjatë vitit 2019.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2020 ishin të projektuara për 2.3 miliardë euro, që është lehtë mbi shpenzimet publike të vitit 2019, duke supozuar rritje reale prej 4.2% të PBB. Shpërthimi i Covid-19 dhe kriza e ndërlidhur i hodhi poshtë këto parashikime. Provat e para tregojnë për një humbje prej 60% në të ardhurat doganore në Mars. Parashikimet e fundit të FMN-së presin që tkurrja e PBB-së reale të jetë në intervalin 6% -7.5% dhe të ardhurat publike pritet të ulen me 200 milionë EUR (2.8% të PBB-së 2019) në 2020. Kosova ka aplikuar për Ndhimë Makro-Financiare nga BE, e cila do të plotësonte kredinë e likuiditetit emergjent të FMN prej 51.6 milionë EUR.

Kontributi i Sektorëve në PBB në Kosovë




Burimi: Agjencia e

Pak progres është bërë në përmirësimin e kualitetit të edukimit dhe në adresimin e hendekut të aftësive në tregun e punës. Ndryshimet strukturore po shfaqen ngadalë dhe ekonomia mbetet shumë e varur nga sektori i tregtisë së brendshme. Rritja e eksportit udhëhiqet kryesisht nga eksporti i shërbimeve në diasporë, ndërsa mungesa e diversifikimit të produkteve, pengon rritjen e eksportit të produkteve.

Për sa i përket përafrimit me standardet evropiane, Kosova është e përgatitur deri në një masë, është bërë progress në fushën e lëvizjes së lirë të mallërave, shërbimeve dhe kapitalit, po ashtu edhe të shërbimeve financiare, prokurimit publik dhe konkurrencës. Progres është bërë edhe në fushat e statistikave dhe kontrollit financiar. Në fushën e taksimit dhe doganave, ka pasur përparim në mbledhjen e të ardhurave nga taksat, zvogëlimin e ekonomisë së hirtë, apo zbatimin e masave doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Për më tepër, Kosova ka bërë përparim edhe në digjitalizimin e ekonomisë.

Në përgjithësi, Kosova, ka nevojë të përmirësojë kapacitetet e saja administrative dhe koordinative, në të gjithë sektorët, për të siguruar zbatim efektiv të “acqui”.

Sektorët si punëdhënës në Kosovë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019

Aktivitetet e Fundit

Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime do të punoj afër me Qeverinë dhe përfaqësuesit e Sektorit Privat dhe asociacioneve të biznesit për të gjetur zgjidhjet më të mira të politikave për rimëkëmbjen ekonomike. Për më tepër, Sekretariati i KKEI është duke punuar intenzivisht në pjesën e riorganizimit dhe çështjeve të tjera rregullative për ta përshtatur Këshillin me praktikën më të mira botërore sa më shpejt që është e mundur.

Sekretariati i KKEI është angazhuar momentalisht në çështjet që kanë të bëjnë me situatën e krijuar me rimëkëmbjen ekonomike duke kryer punën analitike në çështjet me rëndësi të lartë siç janë ndikimi ekonomik, implikimet ligjore për bizneset si dhe ndikimi në punësim. Në anën tjetër, Sekretariati i KKEI është duke mbledhur dhe rishikuar rekomandimet dhe kërkesat që kanë të bëjnë me bizneset, të dërguara nga përfaqësuesit e sektorit privat

Riorganizimi i KKEI - Sekretariati i KKEI në bashkëpunim të ngushtë me Kryeministrin e Kosovës ka bërë ndryshimet e nevojshme rregullative duke përfshirë praktikën më të mira në vendimet e Qeverisë në mënyrë që të sigurohet një funksionim më i mirë dhe efikas i takimeve të KKEI.

Sekretariati i KKEI me udhëheqjen e Kryeministrit të Kosovës, z. Hoti ka organizuar takimin e parë në format të riorganizuar, më 20 Gusht 2020. Shumica e anëtarëve ishin prezent ku edhe kishte kuorum për t'u mbajtur takimi. Kryeministri Hoti theksoi rolin kryesor të asociacioneve të biznesit gjatë procesit të pakos së rimëkëmbjes.

Dukshmëria dhe Transparenca

Krahas riorganizimit, Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime në Kosovë, Sekretariati po ashtu ka bërë edhe ribrandimin e Këshillit, duke ndryshuar emrin, logon dhe faqen e internetit me qëllim të arritjes më të mirë të audiencës së duhur.

Faqja e Internetit të KKEI:

- Krijimi i një faqeje të internetit për herë të parë për Këshillin dhe populimi i saj vazhdimisht me informacione dhe dokumente që nga krijimi i Këshillit
- Publikimi në kohë i aktiviteteve kryesore të Këshillit dhe Sekretariatit të tij

Mediat Sociale:

- Aktivë në tre platforma: Facebook, Twitter dhe LinkedIn
- Vazhdimisht azhurnohet dhe informohet audiencia për aktivitetet e vazhdueshme të Këshillit dhe Sekretariatit të tij

Publikimet:

- Raporti Vjetor
- Buletini tre mujorësh
- Njoftime për shtyp pas çdo takimi



Takimet e Këshillit

Takimi i KKEI i kryesuar nga Kryeministri Hoti – 20 Gusht 2020

Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI) ka mbajtur takimin e parë (me anëtarësi të riorganizuar), të kryesuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti. Takimi i KKEI është mbajtur në format të riorganizuar, me iniciativë të BERZH duke mbështetur Këshillin dhe Sekretariatit e tij. KKEI si platformë kyçe e dialogut publiko-privat ka mbledhur ministrat dhe institucionet që ndërlihen me ekonominë dhe investimet, si dhe përfaqësuesit e asociacioneve të biznesit. Tema kryesore e këtij takimi ishte rimëkëmbja ekonomike si dhe hapat e nevojshëm për të lehtësuar funksionimin e bizneseve gjatë kësaj situate sfiduese të krijuar nga pandemia. Për më tepër, përfaqësuesit e Sekretariatit prezantuan riorganizimin e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

Në fjalimin e tij para anëtarëve të Këshillit, Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, respektivisht edhe Udhëheqësi i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, shprehu falenderimin e tij ndaj BERZH për mbështetjen e dhënë ndaj KKEI dhe ndaj Sekretariatit për përgatitjen raporteve dhe informacioneve të nevojshme rreth bizneseve dhe ekonomisë në vend.

Për më tepër, Kryeministri theksoi nevojën për bashkëpunim ndërmjet institucioneve publike dhe private në implementimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike si dhe draftimin e një strategjie të re zhvillimore për Kosovën në plan afatgjatë. Ai theksoi se ky plan duhet të jetë së paku për një periudhë 5 vjeçare, dhe e njëjta do të arrijë shifrën prej gati 6 miliardë Euro si një ndihmë për ekonominë e vendit. Zv.Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, z. Muharrem Nitaj, tregoi qëndrimin e Ministrisë, duke theksur se 4 shtyllat kryesore për zhvillimin e ekonomisë së qëndrueshme mbeten furnizimi me energji elektrike me një kosto të përballeshme-gjithëmonë në harmoni me obligimet e mbrojtjes së ambientit, implementimi i reformave në ekonomi, zhvillimi i resurseve minerare dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e sektorit privat duke u mbështetur në inovacion dhe transformimin e ekonomisë drejt digitalizimit.

Zv.Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, z. Nexhat Ramadani, theksoi nevojën për subvencionimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe investimeve strategjike si pjesë e planit për rimëkëmbje ekonomike. Ndërsa, Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z.Besian Mustafa, foli rreth rëndësisë së subvencionimit të produkteve thelbësore të bujqësisë për të siguruar qëndrueshmëri ushqimore. Më tutje, Ministri i Pushtetit Lokal, njëherit edhe zv. Kryeministër i vendit, z. Goran Rakic, theksoi se një shumë prej 39 milionë eurosh në total, të cilat do të jenë në dispozicion të komunave në luftën kundër pandemisë, të cilat do të përdoren edhe si ndihmë ndaj bizneseve lokale.

Rekomandimet e sektorit Privat

Kryetari i OEK, z.Berat Rukiqi dhe z.Arian Zeka, Drejtor Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë theksuan se e gjithë kjo situatë paraqet një mundësi për transformimin e ekonomisë. Ata shprehën shqetësimin e tyre rreth situatës në të cilën gjendet turizmi dhe prezantuan rekomandimet e tyre për tërheqjen e investimeve të huaja, si dhe rekomandime rreth mbështetjes së sektorëve të prodhimit dhe gastronomisë, siç janë: ulja e TVSH në 8% për pijet joalkoolike si dhe kompanitë në sektorin HoReCa, programimi i detyrimeve tatiome për një periudhë prej 24 muajsh, si dhe kompenzimi i pagave në normën prej 35%. Z. Panxa kërkoi plotësim ndryshimin e ligjit për prokurim public, ndërsa z.Ardian Shehu mbështeti idenë e procesit të digitalizimit.






Aktivitetet e KKZHE dhe riorganizimi i tij

Pas këtyre diskutimeve, znj. Lindita Daija, Udhëheqëse e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, prezantoi iniciativat e Sekretariatit të KKZHE-së sa i përket pakos së rimëkëmbjes, reportet analitike lidhur me ndikimin e pandemisë në ekonomi, si dhe implikimet ligjore për bizneset. Poashtu, Znj. Daija prezantoi riorganizimin e KKZHE, një process i cili u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me Kryeministrin dhe Kabinetin e tij, në mënyrë që të reflektohen sa më mirë ndryshimet dhe praktikatat e Këshillave Ekonomik dhe të Investimeve nëpër botë, të mbështetur nga BERZH.

Në Fund



Kryeministri i Kosovës, z. Avdullah Hoti u zotua se sektori privat do të jetë pjesë e konsultimeve gjatë dizajnit të kriterëve për shpërndarjen e fondeve, si dhe alokimi i tyre do të bëhet sa më shpejtë të jetë e mundur.

Pakoja e rimëkëmbjes do të jetë pjesë e buxhetit të vitit 2021, do të shfrytëzohet kjo situatë për të transformuar ekonominë tradicionale në ekonomi digjitale. Ligji i prokurimit do të implementohet gjatë periudhës së pandemisë duke u mundësuar kështu kompanive vendore të kenë qasje më të lehtë në tenderët publik, si dhe mbështetje të rezervë ndaj bizneseve të udhëhequra nga gratë. Takimi i Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime ishte organizuar në bashkëpunim të ngushtë në mes kabinetit të Kryeministrit si dhe Sekretariatit të KKEI të mbështetur nga BERZH.

Takimet e KKEI me përfaqësuesit shtesë të sektorit

Kryeministri i Kosovës, z. Avdullah Hoti më 8 Qershor, 2020, ftoi anëtarët e Këshillit si dhe përfaqësues shtesë nga sektori privat, në një takim konsultativ me Ministren e Financave, Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, si dhe Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjet e ndërlidhura me programin e qeverisë dhe rimëkëmbjen ekonomike të pandemisë Covid-19. Ai potencoi se fokusi është tek kompensimi i bizneseve dhe familjeve, më së largu në vjeshtë dhe krijimi i një strategjie të rimëkëmbjes ekonomike në plan afatgjatë.

Takim i KKZHE – Mbledhje e jashtëzakonshme rreth pandemisë Covid-19 – Prill 14, 2020

Sekretariati i KKZHE përgatiti dhe mbajti takimin e 11-të virtual të jashtëzakonshëm të KKZHE më 14, Prill 2020 - të udhëhequr nga Kryeministri, shtatë ministrat – Ministrja e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike; Ministri i Financave dhe Transfereve; Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministri i Shëndetësisë; Ministri i Infrastrukturës; Ministrja e Edukimit dhe Ministrja e Drejtësisë, Drejtori i ATK (Administrata Tatimore e Kosovës), Drejtori i Doganave të Kosovës, Zyra e Përfaqësuesit special të BE, Komisioni Evropian, Ambasada e ShBA, USAID, BERZH, Banka Botërore, 10 përfaqësuesit e asociacioneve të biznesit si dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Takimi u moderua nga Udhëheqësja e Sekretariatit të KKZHE. Sekretariati i KKZHE prezantoi raportet e përgatitura në ndikimin e pandemisë Covid-19 në ekonominë e vendit, poashtu edhe rekomandimet të cilat mund të përdoren për të hartuar pakon pasuese dhe të strategjisë së rimëkëmbjes ekonomike.

Në këtë takim të jashtëzakonshëm, hapat e mëtutjeshëm u diskutuan në mënyrë që zvogëlohet ndikimi negativ në ekonominë e vendit, të shkaktuar nga pandemia e Covid-19. Në këtë takim, i cili synon të përfshijë dialogun publiko-privat, u identifikuan prioritetet dhe sfidat kryesore të ndërlidhura me situatën e krijuar nga pandemia Covid-19, të cilat do të ndikojnë në mënaxhimin e situatës ekonomike të krijuar në Kosovë.

Udhëheqësja e Sekretariatit të KKZHE prezantoi rekomandimet nga analiza e ndikimit të pandemisë Covid-19 në ekonominë e vendit, dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të sektorit privat me Qeverinë. Përfaqësuesit e odave gjatë prezantimeve të tyre shpalosën kërkesat dhe sygjerimet e tyre për hartimin sa më të mirë të pakos së ardhshme.



Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti theksoi rëndësinë e platformës së Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik në dialogun konstruktiv ndërmjet sektorit privat dhe sektorit publik.

Megjithatë, Qeveria e Republikës së Kosovës, përveq masave të ndërmarrë për të ndihmuar situatën e krijuar me shëndetin publik, ka ndërmarrë masa për të ndihmuar edhe

shëndetin ekonomik. Pakon Emergjente Fiskale të draftuar nga Ministri i Financave dhe Transfereve dhe të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kryeministri në detyrë z. Albin Kurti e cilësoi si ndihmë të parë ndaj ekonomisë. Në këtë drejtim, Kryeministri Kurti theksoi se qeveria është duke planifikuar pakon e dytë të rimëkëmbjes ekonomike, e cila “do të jetë me e gjatë dhe më e madhe se pakoja emergjente”.

Si përfundim i këtij takimi, pas votimit, u aprovua propozimi për krijimin e Grupit Koordinues për Covid-19. Ky grup ishte udhëhequr nga Ministria në detyrë e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, znj. Rozeta Hajdari. Ky grup punoi me shpejtësi për të ndërmarrë vendimet e duhura duke u mbështetur në diskutimet dhe analizat konstruktive ndër-institucionale, për të kontribuar në hartimin e masave që i përgjigjen nevojave të sektorit privat.

Takimi i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik ishte organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Kabinetin e Kryeministrit të vendit, Kabinetin e MEPTINIS si dhe Sekretariatit të KKZHE.

Takimi i 9 i KKZHE-14 Janar 2019

Në këtë takim të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj theksoi se ky vit do të jetë viti i ekonomisë dhe fokusi do të jetë në zhvillimin ekonomik, aktivizimin e plotë të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik dhe dhënia e një hapësire më të madhe sektorit privat për të shprehur shqetësimet dhe kërkesat e tyre në lidhje me zhvillimin ekonomik. Për më tepër, gjatë fjalimit të tij, Kryeministri falenderoi partnerët ndërkombëtar për bashkëpunimin dhe për

NCEI 2019–2020

ndarjen e eksperiencave dhe njohurive me shtetin e Kosovës. Më tutje, u theksua nevoja për tërheqjen e investimeve të huaja si dhe progresi i projekteve të ardhshme ekonomike dhe investitorëve strategjik si “Countour Global”, Parku i Inovacionit në Prizren dhe Zona e Veçantë Ekonomike Amerikane në Gjakovë.

Gjatë takimit, pjesëmarrësit e Këshillit Kombëtar shpalosën idetë dhe punën e tyre të cilën e kanë bërë që nga takimi i fundit.

Siç ishte përmendur nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse, një numër i madh i ligjeve dhe rregulloreve që adresojnë barrierat ekonomike, problemet e punësimit etj., janë adresuar. Andaj, përfaqësuesit e sektorit privat u shprehën të kënaqur me reformat fiskale të cilat në të vërtetë i kanë ndihmuar ata. Për në fund, të gjithë u pajtuan që është e rëndësishme së veçantë që palët e interesit të dërgojnë rekomandimet e tyre, në mënyrë që qeveria të mund t'i adresoj këto probleme dhe të ketë më shumë takime të këtij lloji.



Grupet punuese dhe Takimet Teknike

Takim i nivelit të lartë më Ministrin e Drejtësisë dhe Gjyqtarin e Gjykatës Komerciale – Maj 28, 2020

Takimi u mbajt më 28 Maj, 2020, me Ministrin e Drejtësisë dhe Gjyqtarin e Gjykatës së Apelit, respektivisht në Departamentin e çështjeve ekonomike, së bashku me përfaqësuesit e asociacioneve të biznesit. Takimi u moderua nga Udhëheqësja e Sekretariatit të KKZHE.



Sekretariati i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE) ka mbajtur sot takim rreth ndikimit të pandemisë Covid-19 në biznese dhe në perspektivën ligjore të mbrojtjes së tyre në rastet e mospërbushjes së kontratave. Në takim ishin prezent përfaqësuesit e sektorit privat, ministrinë anëtare të KKZHE dhe organizatat ndërkombëtare partnere të KKZHE siç janë: Ambasada e ShBA, BERZH, USAID, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, etj. Diskutimi i takimit kishte për fokus

masat e mundshme që mund të merren nga Ministria e Drejtësisë, puna e gjykatave përkatëse si dhe sugjerimet që u dhanë nga Sekretariati dhe odat për Qeverinë aktuale në lidhje me temën. Raporti i Sekretariatit të KKZHE i titulluar “COVID-19: Implikimet ligjore për Bizneset”, thekson disa nga sfidat të cilat bizneset e vendit duhet t'i kenë parasysh në rast të mosmarrëveshjeve që lindin si rezultat i mos përbushjes së detyrimeve të kontratës, si pasojë e pandemisë. Pas një prezantimi të detajuar të rasteve specifike që lidhen me ndikimin e pandemisë në biznese dhe perspektivën ligjore të mbrojtjes së tyre në

rast të mos përmbushjes së obligimeve të parapara në kontratë, Sekretariati i KKZHE përmendi një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve për Qeverinë dhe institucionet e tjera qeveritare, si për shembull në lidhje me datat e skadimit të kontratës dhe mundësinë e rishikimit të kushteve të kontratave të prokurimit publik nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë. Gjithashtu është me rëndësi procesi i ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis bizneseve. Rekomandimet që duhet të merren parasysh nga Qeveria e Kosovës për të ndihmuar bizneset vendore të cilat po kalojnë një proces të tillë me vështirësi financiare.

Ministria e Drejtësisë ka udhëzuar zyrat e përbaruesve, noterët dhe zyrat e tjera ligjore të marrin në konsideratë mundësitë për të lehtësuar pagesat nga llogaritë që aktualisht bllokohen nga huadhënësit përmes zhbllokimit të përkohshëm të këtyre llogarive ose uljes së kësteve mujore. Ministria e Drejtësisë ka udhëzime për të qenë në përputhje me ligjin aktualisht dhe aktivitetet e anuluar të ndërmjetësimit në terren, si dhe seancat e tjera eventuale, derisa të merret një vendim i mëtejshëm. Për më tepër, Ministria kishte kërkuar nga përbaruesit që të mos debitojnë pagat dhe pensionet e qytetarëve deri në qershor 2020 ose edhe më gjatë, varësisht nga zhvillimi i pandemisë.

Një nga problemet kryesore që mund të lindë me kalimin e kohës është çështja e afateve dhe mënyra e vetme për të parandaluar dëmin që mund t'u shkaktohet palëve kontraktuese është përpjekja për të bërë një interpretim adekuat të instituteve, siç janë klauzolat në lidhje me ndryshimin e kushteve të kontratës ose ngritja çështjes së pandemisë si shkak i mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale. Takimi sqaroi situatat kontraktuale, dhe Gjyqtari i Gjykatës Ekonomike theksoi rëndësinë jetike për krijimin e një gjykate ekonomike dhe rritjen e kapacitetit të saj, veçanërisht në këtë periudhë post-pandemike, e cila është gjithashtu një propozim me shkrim në raportin e përgatitur nga Sekretariati i KKZHE.

Për të gjitha takimet është përgatitur një komunikatë për shtyp të cilat janë publike në dy gjuhë, Shqip dhe Anglisht. Gjithashtu, procesverbali i takimeve është në dispozicion në të dyja gjuhët.

Takim i nivelit të lartë me Grupin Koordinues rreth çështjeve ekonomike të ndërlidhura me Covid-19 - 5 Maj, 2020

Sekretariati i KKZHE mbajti takimin e parë të Grupit Koordinues më 5 Maj, 2020. Grupi Koordinues ishte krijuar me qëllim të trajtimit dhe adresimit të çështjeve ekonomike të sektorit privat si rezultat i pandemisë Covid-19, për të hartuar politikat ndërhyrëse. Anëtarët e Grupit Koordinues mbajtën takimin e parë ku adresuan problemet e ndërlidhura me rimëkëmbjen ekonomike të vendit dhe problemet me të cilat po ballafaqohet sektori privat, si rezultat i pandemisë Covid-19. Ky grup koordinues ishte krijuar në takimin e 11 të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE) të mbajtur më 14 Prill, 2020, nën udhëheqjen e Kryeministrit Kurti dhe me mbështetjen e Sekretariatit të këtij Këshilli.

NCEI 2019–2020

Për të siguruar bashkëpunim adekuat nga Qeveria e Kosovës, anëtarët e këtij grupi ishin: Ministria e Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike; Ministria e Financave dhe Transfereve; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit; Ministria e Shëndetësisë dhe



Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike. Për më tepër, anëtarë ishin edhe Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës. Takimi i parë ishte strukturimi i punës së vazhdueshme në bashkëpunim me akterët përkatës dhe u parashtrua kërkesa që të gjitha kërkesat e shoqatave të biznesit të adresohen përmes Sekretariatit të KKZHE, në mënyrë që të mundësojë përfshirjen e të gjithë sektorëve relevantë të tregut në pakon e rimëkëmbjes ekonomike. Sekretariati i KKZHE vazhdoi të sigurojë mbështetje profesionale dhe analitike për Grupin Koordinues në kryerjen e detyrave të tij.

Takimi përfundoi me pëlqimin e të gjithë anëtarëve për vazhdimin e këtyre takimeve, në baza të rregullta dhe raportim të ngushtë të Kryeministri i Kosovës, deri në përfundimin e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Gjithashtu, në këtë takim u dakorduan që nga kjo platformë e grupit koordinues të krijohen grupe profesionale për adresimin e çështjeve sektoriale në ekonomi / industri, çështje financiare dhe çështje të tjera për të sjellë analizën me konkluzionet më të rëndësishme për hartimin e Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike.

Takim Konsultativ i nivelit të lartë – Ministrat e MEPTINIS, MFT dhe MSH – Prill 28, 2020

Sekretariati i KKZHE organizoi një takim konsultativ më 28 Prill, 2020 me Ministren e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Ministrin e Financave dhe Transfereve, dhe Ministrinë e Shëndetësisë me përfaqësuesit e sektorit privat për fazat fillestare të hapjes pas Covid-19, për bizneset.

Gjatë takimit, Ministri i Shëndetësisë, z.Arben Vitia prezantoi fazat e hapjes të cilat janë të planifikuara të ndodhin gjatë dy javëve të ardhshme. Secila fazë e hapjes parasheh lehtësimin e masave kufizuese që të lejojë bizneset dhe qytetarët t'i kthehen normalitetit. Megjithatë, për sa i përket rekomandimeve të OBSH-së dhe protokollit të ndjekur nga Ministria e Shëndetësisë, të gjitha bizneseve u kërkohet të ndjekin masa specifike mbrojtëse, për të siguruar sigurinë e qytetarëve dhe të kufizojë mundësinë e përhapjes së virusit.

Përfaqësuesit e sektorit privat, duke përfshirë të gjithë anëtarët e KKZHE, si dhe përfaqësuesit e sektorëve të goditur më së rëndi nga masat kufizuese, ato të sektorit HoReCa dhe Rrjeti i Shitësve ishin present në takim. Disa nga çështjet më të ngutshme të cekura nga përfaqësuesit e sektorit privat përfshinin koston e lartë të operimit nën masat e kërkuara, specifikisht nevojën për të angazhuar staf shtesë për të siguruar se numri i konsumatorëve brenda ambienteve të punës të jetë në nivelin e kërkuar.

Takimi përfundoi duke konkluduar se secila fazë e hapjes, do të monitorohet dhe vlerësohet, dhe në rast se ka efekte negative, Qeveria do të rikthej masat ndaluese në një nivel më të lartë. Përderisa përfaqësuesit e sektorit privat ritheksuan koston e lartë të operimit nën masat kufizuese, të dy palët, Qeveria dhe sektori privat ranë dakord mbi rëndësinë e bashkëjetesës me virusin dhe marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të ulur koston e jetëve njerëzore.



Takim i Grupit i nivelit të lartë me Ministrin e Financave dhe Transfereve dhe Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës – 16 Prill, 2020

Takimi u mbajt më 16 Prill, 2020 me të gjithë përfaqësuesit e asociacioneve të biznesit. Në mënyrë që të diskutohet më detajisht Pakoja Emergjente e Biznesit dhe zhvillimet në sektorin financiar nga pandemia Covid-19, Sekretariati i KKZHE ka mbajtur një diskutim me Ministrin e Financave dhe Transfereve, z. Besnik Bislimi dhe Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, z. Fehmi Mehmeti. Takimi u moderua nga Udhëheqësja e Sekretariatit të KKZHE.

Takimi i udhëhequr nga Ministri Bislimi, sqaroi se pakoja do të mbuloj vetëm nevojat emergjente dhe jo të gjitha dëmet me të cilat ballafaqohen bizneset si pasojë e masave të pandemisë. Pakoja emergjente, krahasuar me alternativat e ofruara dhe me hapat të cilët janë ndërmarrë nga vendet e regjionit, është më e kompletuara.

Për më tepër, Ministri sqaroi 4 kategoritë e Pakos Emergjente, të cilat janë mbrojtja e

qytetarëve, punëtorëve, bizneseve dhe komunave, duke dhënë për secilin shpjegim të shkurtër se si synohet të realizohet. Ministri theksoi se ato biznese të cilat kanë larguar nga puna punëtorë, menjëherë pas fillimit të masave të marra për shkak të pandemisë, nuk do të jenë të privileguara nga Pakoja e Rimëkëmbjes, ku kushtet për të marrë kredi do të jenë më të favorshme për ato të cilat kanë mbajtur numrin e njëjtë të punëtorëve. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), z.Fehmi Mehmeti, komunikoi hapat e



ndërmarrja nga institucioni që ai përfaqëson në mbështetje të vendimeve të marra nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë, Takimi përmes z. Mehmeti gjithashtu prezantoi vendimet e BQK-së, siç është moratoriumi i kredisë deri më 30 prill me mundësinë e zgjatjes deri në 3 muaj. BQK-ja ka konsideruar hapat që mund të ndërmerren dhe mundësitë për të ardhmen pas COVID-19, në mënyrë që të mbështesë bizneset në tejkalimin e humbjeve të shkaktuara si rezultat i pandemisë.

Për të sqaruar se cilët segmente të ekonomisë do të preken më shumë gjatë pandemisë Covid-19, Sekretariati i KKZHE kishte përgatitur një raport të ndikimit ekonomik. Bazuar në analizën, ndikimi më i mundshëm i rënies së PBB-së pritet ndërmjet 2-4% dhe në rastet më të rënda deri në 5% ulje. Sa i përket sektorit të punësimit, ka një rënie gjatë kohës së pandemisë, por kjo dukuri shihet me optimizëm për shkak të mundësisë së ringjalljes së tyre pas riaktivizimit të aktivitetit ekonomik.

Takimi i Grupit Punues për Ligjin e Tregtisë së Brendshme me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

Sekretariati riaktivizoi dhe organizoi takimin e tij të parë të grupit të punës. Pas takimit të parë me praninë e Udhëheqëses së Sekretariatit të KKZHE, Qeveria mbështeti propozimin e Udhëheqëses së KKZHE për të filluar me takimet e grupeve të punës. Grupi i parë që u aktivizua ishte Grupi Punues për Çështjet Tregtare dhe Adresimin e Barrierave Tregtare.

Koha ishte e përshtatshme, pasi ajo u zhvillua pas takimit të KKZHE dhe tryezës së rumbullakët me përfaqësuesit e sektorit privat. Një nga temat kryesore të identifikuara në këto takime ka qenë kërkesa e unifikuar e akterëve të sektorit privat në fushën e tregtisë: ligji i brendshëm i tregtisë dhe çështjet e pagesave gjatë marrëveshjeve kontraktuale. Ky takim u mbajt më 24 Prill 2019.

Në këtë takim u ftua eksperti i BE-së i cili ka hartuar ligjin për tregtinë e brendshme dhe u prezantuan çështjet kryesore së bashku me sfidat kryesore. Më shumë se 20 persona ishin të pranishëm, nga të gjithë anëtarët e sektorit privat dhe nga Ministrinë dhe departamentet qeveritare përkatëse, si: Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamenti i Tregtisë dhe Departamenti i Industrisë, etj.

Takimet me sektorin privat

Tryezë e rumbullakët me Sektorin Privat – Nëntor 14, 2019

Sekretariati i KKZHE organizoi një tryezë diskutimi për të bërë një përmbledhje të prioriteteve të sektorit privat. Takimi u zhvillua pas përfundimit të një raundi të plotë të takimeve individuale me përfaqësuesit e Sektorit Privat, anëtarë të KKZHE. Gjatë këtyre takimeve individuale, diskutimet u zhvilluan mbi temat kryesore bazuar në anëtarësimin e tyre dhe rrugën përpara. Pikat kryesore të interesit u përfshinë në axhendën e takimit.

Gjatë takimit, Udhëheqësja e Sekretariatit të KKZHE prezantoi temat kryesore për axhendën e zhvillimit ekonomik, një dokument të përgatitur bazuar në analizën e politikave, takime direkte me përfaqësues të

sektorit privat dhe rekomandimet e akterëve të tjerë. Rekomandimet e politikave u kategorizuan në katër shtylla, plani vjetor i punës i këshillit u azhurnua me fushat prioritare të sektorit privat. Kjo ndihmoi në caktimin e axhendës së qeverisë për takimet e ardhshme të KKZHE me prioritetet e paracaktuara me temat kryesore që do të diskutohen për vitin e ardhshëm, plani i veprimit u azhurnua gjithashtu sipas çështjeve të diskutuara deri më tani. Ky ishte takimi i dytë i mbajtur në të njëjtin format, pas takimit të parë që u mbajt në prill 2019.

Në takim kishte pjesëmarrje të plotë dhe u zhvilluan diskutime intensive, të cilat kontribuan në përcaktimin e temave me prioritet për zhvillimin ekonomik. Rezultati kryesor nga ky takim ishte të kemi një qëndrim të unifikuar midis të gjitha shoqatave të biznesit dhe të dalim me një draft përfundimtar të shtyllave kryesore. Pas takimit të tryezës së rrumbullakët dhe diskutimeve të zhvilluara, u rekomandua që të ketë dy takime të grupeve të punës, përkatësisht për pengesat administrative për bizneset dhe për trajnimin profesional.



Tryezë e Rrumbullakët me Sektorin Privat – prill 24, 2019

Ekonomitë kryesisht ndahen në tre sektorë të veprimtarisë: nxjerrja e lëndëve të para (primare), prodhimi (sekondare) dhe shërbimeve (terciare). Për më tepër, faktorët kryesorë që nxisin rritjen ekonomike janë akumulimi i stokut të kapitalit, rritja e inputeve të punës dhe përparimi teknologjik. Kështu që është e rëndësishme gjithashtu që Kosova të përcaktojë prioritetet e saj kryesore, në mënyrë që të përcaktojë më mirë edhe sektorët ku ekonomia e Kosovës duhet të përqendrohet në mënyrë që të ketë një zhvillim mëtejshëm.

Prioriteti i Këshillit Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik është të shkojë drejt ndërtimit të një axhende për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Në mënyrë që të kemi unifikim nga ana e sektorit privat, Sekretariati i KKZHE organizoi dhe drejtoi takimin e parë të tryezës së rrumbullakët me përfaqësuesit e sektorit privat.

Takimi u zhvillua në Prishtinë më 24 Prill 2019 nga ora 9:30 deri në 12:30, dhe u përmbyll me një drekë pune. Takimi kishte për synim të përcaktojë temat me prioritet dhe pozicionet e unifikuara si sektor privat. Struktura e takimit ishte në fushat kryesore siç janë: çështjet legjislative, pengesat tregtare, çështjet biznes-me-biznes dhe çështjet që lidhen me lehtësimin e investimeve dhe tërheqjen e IHD-ve në vend. Qëllimi përfundimtar ishte përcaktimi i temave kryesore për anëtarët e tyre të biznesit të cilat mund të përkthehen në tema për takimin e ardhshëm të KKZHE të vitit 2019 dhe për më tepër në një axhendë të plotë vjetore. Kontributi i tyre si palë kryesore të interesit gjatë takimit ishte thelbësor për të përcaktuar prioritetet fillestare të zhvillimit ekonomik sipas nevojave të tyre aktuale.

Rekomandimi kryesor ishte që vazhdimi i kësaj tryeze të rrumbullakët është jetike për një arsye shumë të thjeshtë - për të mbajtur përfaqësuesit e sektorit privat të unifikuar për sa i përket qasjes së tyre dhe të sinkronizuar për sa i përket axhendave të tyre.

Raportet analitike të KKZHE të Kosovës - Shtator 2019 - Mars 2020

Ekipi i Sekretariatit të KKZHE vazhdoi të kryejë analiza mbi temat me prioritet të sektorit privat gjatë takimit dhe konsultimit me akterët përkatës. Në këtë mënyrë çështjet analizohen më mire, në mënyrë të plotë dhe propozohen zgjidhje të mundshme të cilat shqyrtohen nga udhëheqësit e qeverisë.

Ekipi i Sekretariatit të KKZHE përgatiti raportet analitike si në vijim:

1. Raport analitik mbi projektligjin e ri për Tregtinë e Brendshme;
2. Raport analitik mbi projektligjin e ri për inspektimet;
3. Një draft i azhurnuar i matricës së Prioriteteve të Sektorit Privat për vitin e ardhshëm për qeverinë e re, i rëndësishëm për prioritetet e zhvillimit ekonomik, duke u bazuar në planin e tyre të fundit legjislativ qeveritar dhe prioritetet e sektorit privat;
4. Raport analitik mbi implikimet për Kosovën të klasifikimit të Bankës Botërore të vendeve të reja sipas nivelit të të hyrave;
5. Raport analitik mbi Pagesat e Vonuara në Transaksionet Komerciale/Tregtare;
6. Raport analitik mbi projektligjin e ri për Tregtinë e Jashtme;
7. Raport analitik për Ligjin e Punës dhe Ligjin për Pushimin e Lindjes dhe Pushimin Prindëror
8. Raport analitik mbi Mangësitë e Aftësive në Tregun e Punës.

Këto raporte ndahen vetëm me BERZH. Plani është që pasi të ketë një Qeveri në vend, së pari të ndahet me autoritetet e caktuara dhe përgjegjëse në Qeverinë e Kosovës. Këto raporte hartohen pas konsultimeve me të gjithë akterët përkatës, përkatësisht me përfaqësuesit e shoqatave të biznesit dhe zyrtarët përkatës qeveritarë. Pastaj këto raporte do të ngarkohen në faqen e internetit. Këto dokumente janë përgatitur në dy gjuhët: shqip dhe anglisht

Raporte të tjera Analitike

Ekipi i Sekretariatit të KKZHE vazhdoi të kryejë analiza mbi temat me prioritet të sektorit privat duke u përqëndruar në çështjet që lidhen me pandeminë Covid-19. Gjatë këtij procesi, palët e interesit u konsultuan dhe u morën të dhëna nga disa partnerë. Për më tepër, pati shumë takime virtuale të mbajtura me palët përkatëse të interesit. Në këtë mënyrë çështjet u analizuan më mirë dhe zgjidhjet e mundshme u qartësuan dhe verifikuan dhe iu paraqitën udhëheqësve përkatës të qeverisë.

Ekipi i Sekretariatit të KKZHE përgatiti raportet analitike dhe dokumente të tjera si në vijim:

1. Masat e propozuara për Qeverinë e Kosovës - Rekomandimet e Sekretariatit të KKZHE së bashku me të gjitha rekomandimet e shoqatave të biznesit - anëtarët dhe partnerët e tjerë të KKZHE;
2. Ndikimi i pandemisë Covid-19 në Ekonominë e Kosovës
3. Implikimet ligjore për bizneset - Covid-19
4. Sekretariati i KKZHE përgatiti listën e vendimeve të lëshuara nga Qeveria, Ministrinë dhe Autoritetet Publike në lidhje me Pandeminë COVID - 19.

5. Sekretariati i KKZHE hartoi rregulloren e re për punën e KKZHE të Kosovës, në lidhje me vendosjen e re të qeverisë, procedurat e strukturuar të anëtarësimit, duke reflektuar praktikat dhe përvojat më të fundit të Këshillave të Investimeve të mbështetura nga BERZH.
6. Sekretariati i KKZHE përgatiti matricën e të gjitha çështjeve të ngritura nga përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve dhe ua përcolli të gjitha Ministrive përkatëse dhe në mënyrë periodike gjatë dy muajve e ridërgonte përsëri me përgjigje, veprime / aktivitete nga institucionet përkatëse.
7. Sekretariati i KKZHE hartoi vendimin e qeverisë për krijimin e Grupit Koordinues - Covid-19 dhe i sugjeroi anëtarët më aktivë Ministrin të Ekonomisë & PTINIS

Të gjitha raportet u përgatitën në gjuhët: shqip dhe anglisht. Këto u ngarkuan në faqen e internetit dhe u ndanë në faqet sociale gjithashtu.

Duke shikuar përpara

Në takimet e ardhshme, Këshilli do të trajtojë çështje që lidhen me klimën e investimeve në kontekstin e zvogëlimit të barrierave në tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Sekretariati në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse dhe institucionet e tjera dhe gjithashtu odat e biznesit do të vazhdojnë të organizojnë tryeza konsultative. Temat që pritet të trajtohen nga Këshilli do të jenë ndryshimi i ligjeve të veçanta përkatëse, transformimi ekonomik, dixhitalizimi i ekonomisë dhe gjithashtu ndërmjetësimi si një mekanizëm alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Një nga aktivitetet kryesore do të jetë përcaktimi i agjendës ekonomike për vitin 2021 në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e KKEI-së, duke bashkëpunuar një dokument me propozime të përgatitur nga Sekretariati, dhe temat më të votuara do të përshkruhen në axhendën ekonomike 2021.





Mbështetur nga:



European Bank
for Reconstruction and Development

Për më shumë informacione ju lutem vizitoni:



www.ncei-ks.com

<https://www.facebook.com/NCEIKosovo>

<https://twitter.com/NCEIKosovo>

<https://www.linkedin.com/in/ncei-kosovo-b341061a4/>

Adresa:

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

Numri kontaktues:

[038 200 365 25](tel:03820036525)

Email:

info@nced-ks.com